

Komunikatë për medie

“Komunë e Hapur II”, thirrja e radhës për rimendimin e hapësirave publike

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës...”, të financuar nga Olof Palme International Center (OPIC), e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë, të premten ka realizuar aktivitetin "Komunë e Hapur II". Kjo performansë publike është vazhdimësi e kërkesës për hapjen e komunës për qytetarë, duke patur për synim promovimin e lëvizjes së lirë në hapësira publike, më shumë hapësira gjelbëruese dhe transparencë në objektet publike.

Në gusht të vitit të kaluar, EC ka prezantuar një propozim për ri-dizajnimin e hapësirës publike të Komunës së Prizrenit (Shtëpia e Bardhë) duke kërkuar largimin e gardhit, shtimin e hapësirës së gjelbër përreth ndërtesës së komunës, shpalljen e një konkursi publik për të ftuar komunitetin e arkitektëve që të konkurrojnë me ide konkrete për të intervenuar në këtë hapësirë dhe zbatimin e kësaj qasjeje edhe në hapësirat përreth institucioneve të tjera publike. Diskutimi është iniciuar në Kuvendin Komunal të Prizrenit dhe i është përcjellë qeverisë lokale për shqyrtim, me ç'rast ekzekutivi deri më sot nuk ka ofruar ndonjë përgjigje.

Për ta fuqizuar edhe njëherë këtë kërkesë, performansa e sotme "Komunë e Hapur II" në mënyrë simbolike përsërit nevojën për lirin e hapësirës publike nga gardhi rrethues që momentalisht ua pamundëson qytetarëve shfrytëzimin e kësaj hapësire publike. Përmes vendosjes së siluetave të individëve të grupeve të ndryshme të komunitetit në gardhin ekzistues, performansa nxjerrë në pah nevojën që qytetarëve t'ju jepet e drejta për depërtim në hapësirën e cila u takon për shfrytëzim.

Hapësirat publike janë mjedise ku qytetarët kalojnë kohën e lirë, shijojnë hapësirat e gjelbra dhe lojërat, shfaqin kulturën dhe identitetin, bashkëveprojnë me individë të komuniteteve të tjera, shkëmbejnë ide, etj. Rimendimi i hapësirës publike rreth objektit të Komunës do të ndikonte pozitivisht në zonën përreth, duke u ofruar qytetarëve një hapësirë publike me mundësi shfrytëzimi dhe plotësimi të nevojave të tyre.

“Qyteti gjithëpërfshirës...” është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje të ndryshme të qytetit.

Me respekt,
Fisnik Minci, koordinator projekti
OJQ EC Ma Ndryshe

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë



OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren ~ Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-5, 10000/Prishtinë
www.ecmandrvshe.org ~ info@ecmandrvshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771